



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
/ Direktorat za Ekonomski Razvoj / Directorate for Economic Development

Data/ Datum/ Date:	29.10.2020
Nr./ Br./ No:	04/32
Për/ Za/ To:	Fermerët e Komunës së Shtimes
Përmes/ Preko/ Through:	Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes
Nga/ Od/ From:	Fitim Hoxha, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
Lënda/ Predmet/ Subject:	Thirrje për Aplikim

Duke u bazuar në: Nenin 62, Paragrafi 62.3 i Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale;
Nenin 5, Paragrafin 5.1 dhe 5.2, Neni 19, Paragrafi 19.1 të Rregullores Nr. 01-060/01-24495/17 për
Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik bën;

Thirrje Për Aplikim

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Shtimes të cilët kultivojnë kultura të ndryshme bujqësore në serra dhe në fushë të hapure e që kanë pasur dëme nga breshëri gjatë vitit 2020 që të aplikojnë për kompensim të pjesshëm të dëmeve.

Kompensimi do të bëhet në bazë të kategorive sipas dëmeve të vlerësuara nga “Komisionit Lokal Për Vlerësim Të Dëmeve Nga Fatkeqësitë Natyrore Dhe Fatkeqësitë Tjera” si në vijim:

Kategoria A, Dëmet e vlerësuar nga 1 deri 99 euro, kompensohen me shumën 50 euro.

Kategoria B, Dëmet e vlerësuar nga 100 deri 499 euro, kompensohen me shumën 100 euro.

Kategoria C, Dëmet e vlerësuar nga 500 deri 999 euro, kompensohen me shumën 300 euro

Kategoria Ç, Dëmet e vlerësuar nga 1000 deri 1999 euro, kompensohen me shumën 600 euro

Kategoria D, Dëmet e vlerësuar nga 2000 deri 4999 euro, kompensohen me shumën 900 euro

Kategoria DH, Dëmet e vlerësuar nga 5000 deri 9999 euro, kompensohen me shumën 1500 euro

Kategoria E, Dëmet e vlerësuar nga 10000 deri 14999 euro, kompensohen me shumën 2000 euro

Kategoria Ë, Dëmet e vlerësuar mbi 15000 euro, kompensohen me shumën 2700 euro

Kriteret për aplikim:

- ✓ Të jenë banorë rezidentë të komunës së Shtimes;
- ✓ Lokacioni i dëmit të jetë në territorin e komunës së Shtimes.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- ✓ Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme jo më e vjetër se 6 muaj;
- ✓ Raporti nga “Komisionit Lokal Për Vlerësim Të Dëmeve Nga Fatkeqësitë Natyrore Dhe Fatkeqësitë Tjera”;
- ✓ Numri identifikues i fermerit (NIF);
- ✓ Konfirmimi i llogarisë bankare;
- ✓ Vërtetimi mbi tatimin në pronë.

Koha dhe mënyra e pranimit të kërkesave:

- ✓ Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 29.10.2020 deri me 12.11.2020
- ✓ Kërkesa duhet të plotësohet dhe së bashku me dokumentet e nevojshme të bashkangjitura duhet të adresohen Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik, përmes zyrës pritëse të komunës;
- ✓ Të gjitha kërkesat do të shqyrtohen nga komisioni vlerësues për ndarje të subvencioneve.

Vërejtje: Fermerëve të cilëve Ministria e Bujqësisë Pylltarisë Dhe Zhvillimit Rural i ka kompensuar dëmet gjatë vitit 2020 përjashtohen në vlerësim.